



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr.188/1Prot

Tiranë, më 27.01. 2026

V E N D I M

Nr. 6, datë 27 . 01. 2026

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË INSPEKTIMIT TË THELLUAR, NË
LIDHJE ME ZBATIMIN E LEGJISLACIONIT TË SHËRBIMIT CIVIL GJATË
ZHVILLIMIT TË PROCEDURËS SË KONKURRIMIT PËR PLOTËSIMIN E
TRE POZICIONEVE VAKANTE TË KRIJUARA NË PERIUDHËN KORRIK-
TETOR 2025, NË INSTITUCIONIN E BASHKISË VLORË**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, si dhe të Rregullores, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me inspektimin e zhvilluar në institucionin e Bashkisë Vlorë,

VËREJ SE:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil nisur nga informacionet e administruara si dhe në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1 dhe neneve 14, 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, neneve 2, 14 germa a), 18 pika 3, 19 pika 1 dhe 21 të Rregullores *“Mbi Procedurat e Mbikëqyrjes/Inspektimit”*, e ndryshuar, me urdhrin nr. 103 (nr. 905 prot.,) datë 03.11.2025 *“Për kryerjen e inspektimit të thelluar, në lidhje me zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil gjatë zhvillimit të procedurës së konkurrimit për plotësimin e pozicioneve vakante të krijuara në periudhën Korrik – Tetor 2025, në institucionin e Bashkisë Vlorë”*, ka filluar kryesisht inspektimin për zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit për plotësimin e për pozicioneve të punës në: **kategorinë e ulët drejtuese**: *“Përgjegjës në Sektorin e Pronave Publike, në Drejtorinë e Pronave Publike & Menaxhimit të Aseteve”*; **në kategorinë ekzekutive**: *“Specialist Administrator Shoqëror NjA Novoselë, në Drejtorinë e Ndihmës dhe Shërbimit Social”*; *“Specialist në Drejtorinë e Bashkëqeverisjes”*; *“Specialist*

Administrator Shoqëror, në Drejtorinë e Ndhmës, Shërbimit Social”; “Specialist Inxhinier Ndërtimi, në Drejtorinë e Urbanistikës”; “Specialist Arkitekt, në Drejtorinë e Urbanistikës”; “Specialist Investimesh, në Drejtorinë e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike” dhe “Specialist Infrastrukture, në Drejtorinë e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike” në institucionin e Bashkisë Vlorë.

I. Qëllimi i inspektimit

- Objekti i inspektimit përfshin zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, gjatë zhvillimit të procedurës së konkurrimit për plotësimin e pozicioneve vakante të krijuara në periudhën Korrik – Tetor 2025, në institucionin e Bashkisë Vlorë.
- Inspektimi ka përfshirë sipas objektit, veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet/mekanizmat e tjera të ngarkuara me detyra specifike gjatë procedurave të konkurrimit.
- Në përfundim të procesit, nëse do të konstatohen shkelje të ligjit, do vijojë procedura me përgatitjen e konkluzioneve dhe hartimin e vendimit paralajmërues për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë. Nëse nuk konstatohen shkelje të ligjit, do të përgatitet vendimi përmbyllës i procesit.

II. Baza ligjore e procesit dhe dokumentacioni i kërkuar

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1 dhe nenin 14, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe neneve 2 dhe 14, germa a), neneve 16 dhe 19, pika 1 dhe 21 të Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, të miratuar me Vendimin nr.17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar, si dhe Urdhrit nr. 103 (nr. 905 prot.,) datë 22.9.2025, *“Për kryerjen e inspektimit të thelluar, në lidhje me zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil gjatë zhvillimit të procedurës së konkurrimit për plotësimin e pozicioneve vakante të krijuara në periudhën Korrik – Tetor 2025, në institucionin e Bashkisë Vlorë”*, të Komisionerit, ka filluar kryesisht verifikimin e zbatimit të ligjit në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me zhvillimin e procedurave të konkurimit të krijuara në periudhën Korrik – Tetor 2025, në Institucionin e Bashkisë Vlorë.

Mënyra e funksionimit të njësive të vetëqeverisjes vendore, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre e të organeve përkatëse, janë të rregulluara me ligjin nr. 139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*. Sipas këtij ligji, njësitë e vetëqeverisjes vendore, janë bashkitë dhe qarqet, të cilat realizojnë vetëqeverisjen vendore në Republikën e Shqipërisë.

Bashkia, si organ i vetëqeverisjes vendore, ka hyrë në skemën e administrimit të shërbimit civil me ligjin nr. 8549/1999 *“Statusi i nëpunësit civil”* (i shfuqizuar) dhe ka ruajtur të njëjtin status edhe me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, pasi në nenin 2 të tij, përcaktohet se, ky ligj zbatohet për çdo nëpunës që

ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore.

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, organet e qeverisjes vendore janë riorganizuar. Konkretisht, në nenin 54 të ligjit, ku parashikohen detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak, në shkronjën “dh” përcaktohet se, **këshilli bashkiak** miraton buxhetin dhe numrin maksimal të punonjësve të bashkisë, si dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë.

Ndërsa në nenin 64 të këtij akti ligjor, ku parashikohen detyrat dhe kompetencat e kryetarit të bashkisë, në shkronjën “j”, përcaktohet se, **kryetari i bashkisë**, miraton strukturën, organikën e kategoritë/klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil dhe rregulloret bazë të administratës së bashkisë dhe të njësive e institucioneve në varësi të bashkisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Aktualisht, në momentin e realizimit të inspektimit, institucioni është i organizuar dhe funksionon mbi bazën e strukturës dhe organikës, të miratuar me Vendimin nr. 3, (nr.792 prot.), datë 17.01.2025, të Kryetarit të Bashkisë Vlorë, “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Vlorë dhe Institucioneve të Varësisë dhe funksioneve të deleguara për vitin 2025”, në zbatim të Vendimit nr. 111, datë 27.12.2024, “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Vlorë për vitin 2025”, të Këshillit Bashkiak. Në strukturë përfshihen: numri i përgjithshëm i punonjësve për administratën e Bashkisë Vlorë, njësitë administrative pjesë përbërëse të saj (Qendër Vlorë, Shushicë, Novoselë dhe Orikum), si dhe institucionet në varësi të kësaj bashkie.

Procesi i inspektimit të thelluar, ka filluar me paraqitjen në subjekt, të grupit të punës, të ngarkuar nga Komisioneri për kryerjen e inspektimit, me përbërje Arbana Basha, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, Alda Xhaxhiu dhe Antea Kabali, me detyrë Inspektore në Drejtorinë e Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, dokumentuar në procesverbalin e datës 10.11.2025, “Procesverbal për fillimin e procesit të inspektimit”, të nënshkruar nga grupi i punës dhe përfaqësuesja e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit.

Administrimi i të dhënave dhe grumbullimi i dokumentacionit në subjekt u realizua sipas objektit të inspektimit, njoftuar institucionit me shkresën nr. 905/1 prot., datë 03.11.2025, “Njoftim për fillimin e procesit të inspektimit të thelluar në lidhje me zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil gjatë zhvillimit të procedurës së konkurrimit për plotësimin e pozicioneve vakante të krijuara nëperiudhën Korrik – Tetor 2025, në institucionin e Bashkisë Vlorë”.

Grupi i punës, me anë të procesverbalit të datës 13.11.2025, “Procesverbal për administrimin e dokumentacionit”, administroi pranë institucionit aktet administrative, të paraqitura si më poshtë:

- Strukturën organizative dhe analitike të Bashkisë Vlorë, e cila është në fuqi për vitin 2025, miratuar me vendim nr. 3, (792 prot.), datë 17.01.2025, të Kryetarit të Bashkisë Vlorë;
- Listëprezencën dhe listë pagesën e punonjësve të institucionit për muajin Tetor 2025;
- Planin vjetor të pranimi për vitin 2025, miratuar me aktin nr. 2430, datë 12.02.2025, të Kryetarit të Bashkisë “Mbi miratimin e planit/rekrutimit në shërbimin civil për vitin 2025;
- Formularët e përshkrimit të punës për pozicionet e punës: “*Specialist në Drejtorinë e Bashkëqeverisjes*”, “*Specialist Administrator Shoqëror, Nj.A.Novoselë, në Drejtorinë e Ndihmës, Shërbimit Social*” dhe “*Përgjegjës në Sektorin e Shpronësimeve në Drejtorinë e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve*”, të përfshira në procesin e konkurrimit nëpërmjet lëvizjes paralele dhe pranimi në shërbimin civil (5 pozicionet e tjera janë pozicione të pezulluara në këtë periudhë për shkak të procesit zgjedhor, por që u morën në shqyrtim nga grupi i punës);
- Urdhër i Brendshëm nr. 492 (15768 prot.), datë 6.1.2025, “Për ngritjen e Komitetit të Përhershëm të Pranimi dhe Komitetit të Ngritjes në Detyrë të punonjësve të Administratës së Bashkisë Vlorë në funksion të shërbimit civil për vitin 2025”, të Kryetarit të Bashkisë Vlorë;
- Dokumentacionin e plotë të administruar në dosjen e konkurrimit, në të cilin materializohet procedura e ndjekur për plotësimin e pozicioneve vakante në fjalë, pranë institucionit të Bashkisë Vlorë, duke filluar me aktet që materializojnë publikimin e vendit vakant; procedurën e konkurrimit të ndjekur në të gjitha fazat e saj; raportin e KPP-së, etj.
- Dosjet me dokumentacionin e dorëzuar nga kandidatët pjesëmarrës në procedurën e konkurrimit për plotësimin e pozicioneve **në kategorinë ekzekutive**: “*Specialist Administrator Shoqëror, Nj.A. Novoselë, në Drejtorinë e Ndihmës dhe Shërbimit Social*”; “*Specialist në Drejtorinë e Bashkëqeverisjes*”; **kategorinë e ulët drejtuese**: “*Përgjegjës në Sektorin e Pronave Publike, në Drejtorinë e Pronave Publike & Menaxhimit të Aseteve*”.
- Shpalljet për publikim për pozicionet e pezulluara, për shkak të procesit zgjedhor “*Specialist Administrator Shoqëror, në Drejtorinë e Ndihmës dhe Shërbimit Social*”; “*Specialist Inxhinier Ndërtimi, në Drejtorinë e Urbanistikës*”; “*Specialist Arkitekt, në Drejtorinë e Urbanistikës*”; “*Specialist Investimesh, në Drejtorinë e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike*” dhe “*Specialist Infrastrukture, në Drejtorinë e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike*” si dhe “*Përgjegjës në Sektorin e Pronave Publike, në Drejtorinë e Pronave Publike & Menaxhimit të Aseteve*” pranë Bashkisë Vlorë;
- Materiale të tjera (akte të cilat janë administruar nga grupi i punës dhe të pasqyruara në procesverbalin e mbajtur në datën 13.11.2025) të cilat u konsideruan të domosdoshme për verifikimin e situatës së administrimit të shërbimit civil në këtë institucion.

III. Metodologjia e përdorur për sistemimin dhe analizën e informacionit të mbledhur, në përputhje me objektin e inspektimit

Grupi i punës ka zgjedhur si metodë pune verifikimin në vend të të gjitha akteve administrative të përmendura më sipër, si dhe të çdo dokumenti tjetër të domosdoshëm për realizimin e objektit të inspektimit. Ky dokumentacion administrohet në arkivin e institucionit, si dhe në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Legjislacionit.

Në zbatim të urdhrit të inspektimit, fillimisht u realizua një takim me njësinë përgjegjëse të institucionit të përfaqësuar nga nëpunësit: Anisa Plepi, e ngarkuar me detyrën e Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Sildi Gjika, Specialist Personeli, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, gjatë të cilit u diskutua për objektin e inspektimit, hapat që do të ndiqen nga inspektorët për realizimin e këtij objekti, si dhe u ra dakord në lidhje me dokumentacionin shkresor që duhej t'i vihej në dispozicion grupit të punës, sipas urdhërit të inspektimit të dërguar pranë institucionit me shkresën nr. 905/1 prot., datë 03.11.2025, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

I gjithë materiali që përmbanin këto akte, u grupua dhe u sistemua në mënyrë analitike, e mbi këtë bazë u nxorrën edhe konkluzionet përmbledhëse për objektin e verifikimit, duke parashtruar rrethanat konkrete, e duke analizuar procedurat përkatëse, si dhe duke përcaktuar mënyrën si duhej trajtuar procesi, shoqëruar edhe me masat për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë.

IV. Situata e administrimit të burimeve njerëzore në momentin e mbikëqyrjes

Në momentin e inspektimit, institucioni i Bashkisë Vlorë funksionon mbi bazën e strukturës organizative të miratuar me Vendimin nr. 3, (792 prot.) datë 17.01.2025, të Krytarit të Bashkisë Vlorë, *“Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Vlorë dhe institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara për vitin 2025”*.

Nga analiza e strukturës që është në fuqi në momentin e inspektimit, rezulton se, institucioni i mbikëqyrur ka gjithsej **404** pozicione pune të miratuara për aparatën e bashkisë dhe njësitë administrative Novoselë, Orikum, Qendër Vlorë dhe Shushicë. Bazuar në funksionet që ato kryejnë, situata paraqitet si më poshtë:

- **1** pozicion pune, funksionar i zgjedhur, (Kryetari).
- **15** pozicione pune, funksionarë kabineti, (Nënkryetar, Drejtor Kabineti, Këshilltar dhe Sekretar i Këshillit Bashkiak).
- **238** pozicione pune, punonjës administrativë, (të cilët kryejnë funksione jashtë shërbimit civil, për të cilët marrëdhënia juridike e punës rregullohet sipas dispozitave të parashikuara në Kodin e Punës dhe ligjet organike).
- **150 pozicione pune janë pjesë e shërbimit civil.**

Duke vlerësuar klasifikimin e pozicioneve të shërbimit civil, sipas përcaktimeve të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar dhe vendimit nr. 142, datë

12.3.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, **150 pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil** në administratën e Bashkisë Vlorë, paraqiten në këtë raport:

- Nëpunës civilë të kategorisë së lartë drejtuese - **3 pozicione pune**, të cilat i përkasin pozicionit të punës “*Drejtor i Përgjithshëm*”.
- Nëpunës civilë të kategorisë së mesme drejtuese - **13 pozicione pune**, të cilat i përkasin pozicionit “*Drejtor Drejtorie*”.
- Nëpunës civilë të kategorisë së ulët drejtuese - **13 pozicione pune**, të cilat i përkasin pozicionit “*Përgjegjës Sektori*”.
- Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive - **121 pozicione pune**, të cilat i përkasin pozicionit “*Specialist*”.

Në momentin e inspektimit rezultojnë të plotësuara **124 pozicione pune** në shërbimin civil, ndërsa **26 pozicione pune** rezultojnë vende të lira (3 pozicione “*Drejtor i Përgjithshëm*”; 12 pozicione “*Drejtor Drejtorie*”; 1 pozicion “*Përgjegjës Sektori*”; 10 pozicione “*Specialist*”).

V. Plan i vjetor i pranimit në shërbimin civil

Administrimi i shërbimit civil për të gjithë institucionet e administratës shtetërore bazohet në planin vjetor të pranimit në shërbimin civil, në zbatim të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe të Vendimit nr. 108, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, në të cilin janë përcaktuar procedurat e hollësishme për përgatitjen, miratimin, afatin e miratimit dhe mënyrën e bërjes publike të planit vjetor të punësimit.

Përgatitja e tij në mënyrë të detajuar dhe në përputhje me kërkesat ligjore, përbën një garanci për zhvillimin e gjithë procedurave të konkurrimit. Duke vazhduar më tej, në zbatim të detyrimeve të nenit 18, të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ku përcaktohet se; “...dhe çdo institucion i pavarur, jo më vonë se muaji shkurt, miratojnë planet e veta të pranimeve vjetore....”, institucioni duhet të miratojë planin vjetor të pranimit për pozicionet e lira pjesë e shërbimit civil, në bazë të të cilave administrohet i gjithë procesi i rekrutimit.

Këto dispozita përcaktojnë se, institucionet e pavarura, në përgatitjen e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil, duhet të kenë parasysh nëpunësit që mbushin moshën për pensionin e plotë të pleqërisë, krijimin e vendeve të reja të punës pjesë e shërbimit civil për shkak të ndryshimit të strukturës, si dhe krijimin e vendeve të lira për arsye të tjera, të cilat publikohen në portalin: “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”, në faqen zyrtare të internetit dhe në stendat për njoftime publike të institucionit.

Për vitin 2025, me aktin nr. 2430 prot., datë 12.02.2025, “Mbi miratimin e planit të pranimit/rekrutimit në shërbimin civil për vitin 2025”, të hartuar nga njësia përgjegjëse

dhe të miratuar nga Kryetari, institucioni ka miratuar planin vjetor të pranimi, në bazë të të cilit janë parashikuar për t'u zhvilluar procedurat e konkurrimit për **20 pozicione** pune të lira, të ndara sipas kategorive:

- 1 pozicion pune i kategorisë së nivelit të lartë drejtues;
- 5 pozicione pune të kategorisë së nivelit të mesëm drejtues;
- 2 pozicione pune të kategorisë së nivelit të ulët drejtues;
- 12 pozicione pune të kategorisë ekzekutive.

Aktualisht në momentin e inspektimit, rezultojnë **26 pozicione pune** si vende të lira (3 pozicione “Drejtor i Përgjithshëm”; 12 pozicione “Drejtor Drejtorie”; 1 pozicion “Përgjegjës Sektori”; 10 pozicione “Specialist”, të cilat nuk janë pasqyruar në planin e rekrutimit.

Në lidhje me sa më sipër, sjellim në vëmendje të njësisë përgjegjëse të institucionit, se duhet të tregojë kujdes në përgatitjen e planit të nevojave për rekrutim, në përputhje me përcaktimet e Vendimit nr. 108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimi në shërbimin civil”, kryesisht për pozicionet e lira të cilat nuk janë të planifikuara, por që krijohen gjatë vitit kalendarik si rrjedhojë e aplikimit të instituteve të tjera të ligjit, të cilat duhet të pasqyrohen si ndryshime të aktit administrativ të planit të rekrutimit, me qëllim që të vijojnë procedurat për plotësimin e pozicioneve të lira.

VI. Plotësimi i pozicioneve të lira në shërbimin civil në nivelin ekzekutiv

Bazuar në kreun IV, V dhe VI, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pozicionet e lira pjesë e shërbimit civil, plotësohen vetëm nëpërmjet procedurave të konkurrimit dhe njësi përgjegjëse për realizimin e procedurave të konkurrimit, është njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit.

Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë ekzekutive në shërbimin civil nëpërmjet konkurrimit të hapur, rregullohet nga ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (Kreu IV, “Pranimi në shërbimin civil”, nenet 20, 21, 22, 23 e 25); Vendimi nr. 243, datë 18.3.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimi nr. 2, datë 27.3.2015, i Departamentit të Administratës Publike, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të cilit i referohemi për analogji.

Dispozitat ligjore si më sipër, përcaktojnë rregullat procedurale të konkurrimit, për plotësimin e pozicioneve të punës në nivelin ekzekutiv, sipas të cilave, për plotësimin e vendeve të lira në këtë rast, fillimisht organizohet *procedura e lëvizjes paralele*, e më pas, nëse mbeten pozicione të lira, pas aplikimit të procedurës së lëvizjes paralele, njësia

përgjegjëse, i plotëson ato me anën e procedurës për pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive.

Grupi i punës, verifikoi në mënyrë të hollësishme të gjithë hapat proceduralë që ka ndjekur institucioni, për menaxhimin e procesit të konkurrimit, ndër të cilat:

1. Shpalljen e konkurrimit për vendin e lirë në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, si dhe në faqen zyrtare të institucionit;
2. Verifikimin paraprak nga njësia përgjegjëse, nëse kandidatët i plotësojnë ose jo kërkesat e përgjithshme dhe ato të posaçme sipas shpalljes së konkurrimit;
3. Vlerësimin e kandidatëve nga Komiteti i Brendshëm për Lëvizjen Paralele dhe Komiteti i Përhershëm i Pranimit, i cili përfshin vlerësimin e jetëshkrimit të kandidatëve, testimin me shkrim dhe vlerësimin e intervistës së strukturuar me gojë;
4. Shpalljen e listës së fituesve, administrimin e kësaj liste nga njësia përgjegjëse dhe nxjerrjen e aktit të emërimit në shërbimin civil për kandidatët fitues.

Nga analiza e dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të punës, rezultoi se nuk ka patur asnjë emërim nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ndërsa nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, kanë përfunduar me fitues pozicionet e punës të shpallura për publikim, si më poshtë:

- Shpallje për lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil “Lloji i diplomës: “Arsim i Lartë”, niveli minimal i diplomës “Master Profesional”, - pozicioni i punës “Specialist” në Drejtorinë e Bashkëqeverisjes”, kategoria -IV-2 (Kandidatë fitues Klodiana Muaj, Alma Sula, Lori Liko, është emëruar kandidatja Sabrina Xheja nga lista e pritjes);
- Shpallje për lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil “Lloji i diplomës: “Arsim i Lartë”, niveli minimal i diplomës “Master Profesional”, - pozicioni i punës “Specialist Administrator Shoqëror” në NJ. A Novoselë, në Drejtorinë e Ndihmës, Shërbimit Social, kategoria -IV-2 (emëruar kandidatja Lindita Selimaj);

Gjithashtu u konstatuan edhe 5 procedura konkurrimi, pozicione të nivelit ekzekutiv, të cilat janë publikuar si të lira, por që rezultuan të papërfunduara, pasi ishin pezulluar për shkak të periudhës zgjedhore:

- Shpallje për lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil “Lloji i diplomës: “Arsim i Lartë”, niveli minimal i diplomës “Master Profesional”, - pozicioni i punës “Specialist Administrator Shoqëror”, në Drejtorinë e Ndihmës, Shërbimit Social, kategoria - IV-2 (akti nr. 15193 prot., 18.09.2025)
- Shpallje për lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil “Lloji i diplomës: “Inxhinieri Ndërtimit” dhe “Arkitekturë”, niveli minimal i diplomës “Master Shkencor”, - 2 pozicione pune “Specialist Inxhinier Ndërtimi” dhe “Specialist Arkitekt”, në Drejtorinë e Urbanistikës, kategoria - IV-2 (akti nr. 16773 prot., datë 15.10.2025);

- Shpallje për lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil “Lloji i diplomës: “Inxhinieri Ndërtimit”, niveli minimal i diplomës “Master Shkencor”, - 2 pozicione pune “Specialist Investimesh” dhe “Specialist Infrastruktura”, në Drejtorinë e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike, kategoria - IV-2 (akti nr. 16774 prot., datë 15.10.2025).

Në vijim do të analizohen fazat e rekrutimit sipas kërkesave të ligjit:

1. *Shpallja e konkurrimit për vendin e lirë në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, si dhe në faqen zyrtare të institucionit, për pozicionet e publikuara.*

Nga verifikimi i akteve, të cilat materializojnë procedurat e konkurrimit të shpallura nga njësia përgjegjëse pranë institucionit, për plotësimin e vendeve të lira, konstatohet se për **pozicionet** e shpallura që janë objekt inspektimi, është vepruar si më poshtë:

- ✓ Është bërë shpallja e procedurës së pranimi në portalin e “Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, si dhe në faqen zyrtare të institucionit duke pasqyruar në përmbajtje të gjithë informacionin e parashikuar nga legjislacioni specifik që rregullon këtë aspekt.

Për të gjitha pozicionet e publikuara, janë respektuar afatet e parashikuara në pikën 8 e 10, të Kreut II, të Vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, i ndryshuar, shpallja e procedurës së pranimi bëhet të paktën 35 ditë kalendarike para datës së parashikuar për zhvillimin e konkurrimit; afati i dorëzimit të dokumentacionit për lëvizje paralele jo më pak se 10 ditë kalendarike nga dita e parë e shpalljes; për pranim në shërbimin civil jo më pak se 15 ditë kalendarike nga dita e parë e shpalljes (*Është parashikuar saktë që aplikohet në të njëjtën kohë për të dy procedurat: lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil, duke përcaktuar për secilën procedurë afatin e dorëzimit të dokumenteve me datë të saktë kalendarike*).

Gjatë mbikëqyrjes, rezulton se, detyrimi ligjor, nga ana e institucionit në lidhje me transparencës dhe respektimin e shanceve të barabarta, **është përmbushur për të gjitha procedurat e shpallura**, duke e publikuar njoftimin në faqen zyrtare të institucionit, si dhe nëpërmjet akteve zyrtare përkatëse, në portalin e AKPA-së.

Në të gjitha publikimet, njësia përgjegjëse, **ka vepruar** në përputhje me rregullimet e pikës 1 dhe 2, të nenit 25, të ligjit për nëpunësin civil, ku parashikohet se, plotësimi i vendeve të lira në kategorinë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet së pari, nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe nëse në përfundim të kësaj procedure nuk ka një fitues, atëherë njësia përgjegjëse organizon procedurën e pranimi në shërbimin civil nëpërmjet konkurrimit të hapur.

Ndërkohë, u konstatua se për 5 pozicionet e tjera të publikuara (në 3 shpallje), por që rezultuan të pezulluara për shkak të procesit zgjedhor, të cilat ende nuk janë finalizuar,

nuk është respektuar afati 10 ditor i publikimit. E sjellim në vëmendje të njësishë përgjegjëse, që të ketë kujdes në të ardhmen të respektohen afatet me qëllim që raste të tilla të mos përsëriten. Konkretisht bëhet fjalë për këto veprime administrative:

- Shpallje për lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil “Lloji i diplomës: “Arsim i Lartë”, niveli minimal i diplomës “Master Profesional”, - pozicioni i punës “Specialist Administrator Shoqëror”, në Drejtorinë e Ndihmës, Shërbimit Social, është dërguar për publikim në AKPA akti nr. 15193 prot., datë **18.09.2025**, afati për dorëzimin e dokumentave për lëvizjen paralele është **26.09.2025** dhe për pranim **01.10.2025**;
- Shpallje për lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil “Lloji i diplomës: “Inxhinieri Ndërtimit” dhe “Arkitekturë”, niveli minimal i diplomës “Master Shkencor”, - 2 pozicione pune: “Specialist Inxhinier Ndërtimi” dhe “Specialist Arkitekt”, në Drejtorinë e Urbanistikës, kategoria - IV-2, është dërguar për publikim në AKPA akti nr. 16773 prot., datë **15.10.2025**, afati për dorëzimin e dokumentave për lëvizjen paralele është data **12.10.2025** dhe për pranim data **17.10.2025**.
- Shpallje për lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil “Lloji i diplomës: “Inxhinieri Ndërtimit”, niveli minimal i diplomës “Master Shkencor”, - 2 pozicione pune: “Specialist Investimesh” dhe “Specialist Infrastruktura”, në Drejtorinë e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike, kategoria - IV-2, është dërguar për publikim në AKPA akti nr. 16714 prot., datë **15.10.2025**, afati për dorëzimin e dokumentave për lëvizjen paralele është data **12.10.2025** dhe për pranim data **17.10.2025**.

Në vijim të analizës për publikimin e pozicioneve të lira: “Specialist” në Drejtorinë e Bashkëqeverisjes”; “Specialist Administrator Shoqëror” në NJA Novoselë, në Drejtorinë e Ndihmës, Shërbimit Social dhe “Specialist Administrator Shoqëror”, në Drejtorinë e Ndihmës, Shërbimit Social, konstatohet se në përmbajtje të shpalljes për të cilat do të zhvillohet konkurrimi, janë përcaktuar: përshkrimi përgjithësues i pozicioneve të punës; kriteret e përgjithshme; dokumentacioni që do të paraqitet; data për paraqitjen e aplikimit; data e zhvillimit të konkurrimit; data për shpalljen e rezultateve pas verifikimit paraprak; mënyra e vlerësimit dhe njohuritë, aftësitë apo cilësitë që do të vlerësohen në konkurrim, por gjatë analizës së dokumentacionit u konstatuan edhe disa mangësi si më poshtë:

- **mungon** fusha kryesore mbi të cilën do të realizohet konkurrimi, si element bazë në verifikimin e kandidatëve si psh: “Lloji i diplomës: “Arsim i Lartë”, niveli minimal i diplomës “Master Profesional”;
- si dhe publikimi **nuk është bërë për grup pozicionesh**, për të cilat lloji i diplomës që kërkohet dhe kërkesat e posaçme të pozicionit të punës janë të njëjta, në rastin konkret është i njëjtë për të 3 pozicionet.

Në zbatim të nenit 19, pika 8, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pozicionet e nivelit ekzekutiv klasifikohen sipas natyrës së pozicionit, konkretisht në grupet e administrimit të përgjithshëm dhe në grupet e administrimit të posaçëm. Më tej, në Kreun II, pika 1, të Vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për

pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, përcaktohet se, procedura e pranimit në shërbimin civil, organizohet në mënyrë të ndarë për grupin e pozicioneve të administrimit të përgjithshëm dhe për çdo grup të pozicioneve të administrimit të posaçëm. Në rastin e institucionit objekt mbikëqyrjeje, miratimi i strukturës dhe organikës së re e mundëson realizimin e konkurrenive sipas grupeve të administrimit të posaçëm, për pozicionet “*Specialist*”, të cilat i përmendëm më sipër dhe për të cilat, njësia përgjegjëse **duhet të kishte zhvilluar procedurën e rekrutimit në grup**. Realizimi i procedurës në grup, shërben për të garantuar një proces përzgjedhës transparent të nëpunësve civilë, si dhe ndikon në kryerjen në mënyrë sa më efektive të procedurave të konkurrimit.

2. Pas verifikimit paraprak nga njësia përgjegjëse, lista me kandidatët e kualifikuar **është dërguar për tu shpallur** në portalin AKPA, si edhe përmes postës elektronike e-mail, por rezulton i papërfunduar si proces, pasi nuk është bërë verifikimi përfundimtar, në këto kushte jemi para faktit që nuk mund të verifikohet a është respektuar procesi i ankimimit në respektim të aktit nënëligjor sa më sipër, gjithashtu nuk rezulton të jete mbajtur lista me kandidatët që nuk plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçantat, ndërkohë grupi i punës i ka bërë verifikimet nga e-mailet e dërguara në mënyrë individuale aplikantëve që nuk përmbushin kërkesat e vendosura në publikim.
3. Me Urdhërin e Brendshëm nr. 492 (15768 prot.,) datë 29.09.2025 “Për krijimin e Komitetit të Përherhshëm të Pranimit dhe të Komitetit të Ngritjes në Detyrë të punonjësve të administratës së Bashkisë Vlorë në funksion të shërbimit civil”, të Kryetarit, **janë formuar dy organet**: Komiteti i Përhershëm i Pranimit dhe Komiteti i Ngritjes në Detyrë, në **një akt të vetëm**.

Në këto kushte, njësia përgjegjëse, duhet të ketë në vëmendje se, akti për krijimin e secilit organ dhe vlerësimi gjatë procedurës së konkurrimit duhet të **jenë individual**, pasi, elementët e akteve administrative për ngritjen e KPP dhe KPND janë të ndryshëm përsa i takon bazës ligjore ku mbështet krijimi i tyre, si dhe përbërjes së këtyre organeve, e po kështu edhe vlerësimet që ato do të kryejnë (ç’ka do të do të sqarohet në vijim të materialit).

4. Në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, KPP, **ka listuar** kandidatët fitues me mbi 70 pikë (mbi 70/% të pikëve), duke filluar nga kandidati me rezultatin më të lartë dhe brenda afateve, ja ka dërguar njësisë së burimeve njerëzore, e cila, listën e fituesve, e ka shpallur në portalin “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*”, në faqen e internetit të institucionit dhe në standat e informimit të publikut. Më pas njësia përgjegjëse ka vijuar me nxjerrjen e aktit të emërimit të kandidatëve fitues.

Në vijim të vendimit janë pasqyruar hapat e ndjekur gjatë procedurës së rekrutimit për secilën fazë të konkurrimit, atë të lëvizjes paralele dhe pranimit në shërbimin civil, për pozicionet objekt inspektimi:

- a. **Procedura e ndjekur gjatë fazës lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil, përmes së cilës janë plotësuar pozicionet: “Specialist” në Drejtorinë e Bashkëqeverisjes, kategoria -IV-2”, “Lloji i diplomës: “Arsim i Lartë”, niveli minimal i diplomës “Master Profesional” dhe “Specialist Administrator Shoqëror” në NJ.A Novoselë, në Drejtorinë e Ndihmës, Shërbimit Social, kategoria -IV-2”, “Lloji i diplomës: “Arsim i Lartë”, niveli minimal i diplomës “Master Profesional”, në Bashkinë Vlorë**

Shpallja e konkurrit për lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil, për secilin pozicion dhe **jo për grup pozicionesh**, me kriter “Lloji i diplomës: “Arsim i Lartë”, niveli minimal i diplomës “Master Profesional”, është dërguar për publikim në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” (AKPA) dhe në faqen e internetit të institucionit, (respektivisht aktet nr. 13503 prot., datë 13.08.2025 dhe nr. 13390 prot., datë 11.08.2025), të njësisë përgjegjëse të institucionit.

Ashtu si edhe e kemi sqaruar më sipër grupi i punës konstatoi se pozicionet mund të ishin publikuar në një shpallje të vetme, për faktin se kriteri po ashtu edhe përshkrimi përgjithësues i pozicionit është i njëjtë.

✓ **Procedura e lëvizjes paralele:**

Në kreun VII, pika 6, të VKM-së nr. 243, datë 18.3.2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, e ndryshuar, përcaktohet se, konkurrimi zhvillohet në dy faza:

- a) verifikimin e kandidatëve, të cilët përmbushin kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim;
- b) vlerësimin e kandidatëve, ku përfshihen vlerësimi i përvojës në punë, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse, si dhe vlerësimet pozitive dhe intervista e strukturuar me gojë.

Sipas pikës 7, të këtij kreu, njësia e burimeve njerëzore, në bazë të dokumentacionit të paraqitur, jo më vonë se 2 (dy) ditë kalendrike nga data e mbylljes së pranimin të tyre, bën verifikimin paraprak të kandidatëve që përmbushin kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

- a. Në plotësim të këtij detyrimi ligjor, njësia përgjegjëse ka kryer verifikimin paraprak të kandidatëve dhe me aktin nr. 13503/1 prot., datë 25.08.2025, “Njoftim”, për **fazën e lëvizjes paralele**, për pozicionin “*Specialist*” në Drejtorinë e Bashkëqeverisjes”, ku është kualifikuar kandidatja Sevin Aliaj. Rezulton se kandidatë të s’kualifikuar nuk ka pasur.

Në lidhje me këtë procedurë konkurimit rezulton se:

- ✓ Me Urdhërin e Brendshëm nr. 460 (14598 prot.) datë 08.09.2025 “Për krijimin e Komisionit të Pranimit për Lëvizjen Paralele” për pozicionin “Specialist”, në Drejtorinë e Bashkëqeverisjes, në përbërje të Komisionit, janë 3 anëtarë, ku përcaktohen punonjësit A. Male në cilësinë e eprorit direkt, A. Plepi dhe A. Mësonjësi (ky punonjës ka ardhur me transferim të përkohshëm nga MBZHR, shkresa e DAP nr. 3740/2 prot., datë 28.07.2025), si anëtarë të zgjedhur nga titullari i institucionit, nëpunës në kategorinë e mesme drejtuese;
 - ✓ Sipas procesverbalit të prezencës (*dokument i cili u administrua nga grupi i punës, i cili nuk ka një datë të caktuar, por nga analiza edhe e akteve të tjera pjesë e dosjes së konkurimit, grupi i punës arriti në konkluzionin që veprimi administrativ është zhvilluar në datën 10.09.2025*), konstatohet se, kandidatja nuk është paraqitur, në këto kushte **procedura e mësipërme është përmbyllur pa fitues**;
 - ✓ Rezulton se KBLP **është mbledhur** për të hartuar pyetjet e intervistës së strukturuar me gojë, dhe janë hartuar 5 pyetje, të cilat janë nga fusha e njohurive të kërkuara në shpalljen e pozicionit vakant, sipas përcaktimit të pikës 16, kreu VII, i VKM-së nr.243, datë 18.3.2015, i ndryshuar;
 - ✓ Anëtarët e Komisionit të Brendshëm për Lëvizjen Paralele **kanë nënshkruar** deklaratat e paanësisë, datë 10.09.2025;
 - ✓ Në përfundim me aktin nr. 13503/2, datë 15.09.2025, është konsideruar e përmbyllur procedura e lëvizjes paralele dhe është hapur procesi për të zhvilluar procedurën e pranimit në shërbimin civil.
- b. Në lidhje me pozicionin e punës **“Specialist Administrator Shoqëror” në NJA Novoselë, në Drejtorinë e Ndihmës, Shërbimit Social**, njësia përgjegjëse ka kryer verifikimin paraprak të kandidatëve, nga ku rezultoi se nuk kishte aplikantë të interesuar për këtë fazë të konkurimit dhe me aktin nr. 13390/1 prot., datë 25.08.2025, “Njoftim”, është dërguar njoftimi në AKPA, për **përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele** dhe vijimin e procedurës së pranimit në shërbimin civil.

Në përfundim të vlerësimit të kësaj procedure konkurrimi, **lëvizje paralele**, Komisioneri vlerëson se veprimet e aktorëve që kanë marrë pjesë në këtë proces janë zhvilluar në përputhje me ligjin.

✓ **Procedura e pranimit në shërbimin civil:**

Në kushtet kur lëvizja paralele ka përfunduar pa kandidatë fitues, sipas dispozitave ligjore, që përcaktojnë qartë rregullat procedurale të konkurimit, për plotësimin e pozicioneve të punës në nivelin ekzekutiv, sipas të cilave, fillimisht organizohet procedura e lëvizjes paralele, e më pas, nëse mbeten pozicione të lira, njësia përgjegjëse, i plotëson ato me anën e procedurës për pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive, ka vijuar procesi i pranimit në shërbimin civil për të dy pozicionet e publikuara **“Specialist” në Drejtorinë e Bashkëqeverisjes dhe “Specialist Administrator Shoqëror” në NJA Novoselë, në Drejtorinë e Ndihmës, Shërbimit Social**.

Në kreun IV, pikat 1, të VKM-së nr. 243, datë 18.3.2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, e ndryshuar, përcaktohet se, konkurrimi zhvillohet në dy faza:

- a) Verifikimi paraprak, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse kandidatët plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe ato të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim;
- b) Vlerësimi i kandidatëve.

Grupi i punës, verifikoi në mënyrë të hollësishme të gjithë procedurën që ka ndjekur institucioni i mbikëqyrur, për menaxhimin e procesit të konkurrimit për pozicionin e publikuar (procesi i publikimit në portalin e AKPA-së është analizuar më sipër).

- a) Verifikimi paraprak, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse kandidatët plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe ato të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim

- ✓ Verifikimi paraprak i kandidatëve është kryer **brenda afatit** prej 16 ditë kalendarike, nga data e mbylljes së pranimin të dokumentacionit, afat ky i përcaktuar në pikën 2, të kreut IV, të VKM nr. 243, dt. 18.3.2015, i ndryshuar;
- ✓ Pas verifikimit paraprak nga njësia përgjegjëse, lista me kandidatët e kualifikuar **është shpallur** në portalin e “Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, si dhe në faqen zyrtare të institucionit (akti nr. 13503/3 prot., datë 15.09.2025 verifikimi paraprak për pozicionin “Specialist” në Drejtorinë e Bashkëqeverisjes” dhe akti nr. 13390/3 prot., datë 16.09.2025 “Specialist Administrator Shoqëror” në NJA Novoselë”, i cili është konsideruar edhe si listë përfundimtare);
- ✓ Për procedurën e zhvilluar për pozicionin “**Specialist Administrator Shoqëror**” në NJA Novoselë”, rezulton që, nuk është respektuar procesi i ankimimit sipas pikës 6 të aktit nënligjor, testimi me shkrim do të zhvillohet në datën 23.09.2025, ora 10.00 (nga njësia përgjegjëse na u justifikua që nuk kishte kandidatë të skualifikuar);
- ✓ Për procedurën “**Specialist**” në Drejtorinë e Bashkëqeverisjes”, është respektuar procesi i ankimimit sipas pikës 6 të aktit nënligjor (nga njësia përgjegjëse është mbajtur një procesverbal konstatimi ku tregohet që është respektuar procesi, materiale të cilat janë administruar në akt konstatimet e mbajtura nga grupi i punës);
Lista përfundimtare e kandidatëve të kualifikuar është dërguar në AKPA, së bashku me përcaktimin për datën, orën dhe vendin kur do të zhvillohet testimi me shkrim (akti nr. 13503/4 prot., datë 22.09.2025, testimi do të zhvillohet në datën 30.09.2025).

- b) Ndërsa, **vlerësimi i kandidatëve, i cili kalon në tre procese**, vlerësimi me shkrim, vlerësimi i jetëshkrimit dhe vlerësimi i intervistës së strukturuar me gojë, janë detyra ekskluzive të Komiteteve, të ngritura në secilën procedurë konkurrimi, të cilat do ti trajtojmë në vijim.

Nisur nga përcaktimi i pikës 4, të nenit 22, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe rregullave të përcaktuara në Kreun III dhe IV (pikat nga 7 deri në 13), të VKM nr. 243, dt. 18.3.2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar, kandidatët e kualifikuar për të kaluar në fazën e dytë të konkurrimit, vlerësohen nga **Komiteti i Përhershëm i Pranimit (KPP)**.

Krijimi i KPP, përbërja e tij, si dhe detyrat që duhet të kryejë ky organ, janë të parashikuara në Kreun III dhe IV të aktit nënligjor në fjalë, si dhe në ndarjen III/3, III/4, III/5, III/6, III/7 e III/8, të Udhëzimit nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”.

Gjatë procesit të inspektimit, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar, konstatohet se, në zbatim të rregullave të parashikuara në dispozitat si më sipër, institucioni **ka ngritur KPP-në**, me 5 anëtarë (akti nr. 494 (15770 prot.) datë 29.09.2025 dhe akti nr. 493 (15769 prot.) datë 29.09.2025), me përbërje si më poshtë:

- 1 anëtar nga njësia e burimeve njerëzore Anisa Plepi- Drejtor (**i ngarkuar me detyrën e DBNJ**) (kjo nëpunëse, në momentin e konkurimit ka qenë e komanduar me detyrën e drejtuesit të njësisë përgjegjëse të institucionit, ndërkohë që gëzon statusin e nëpunësit civil në pozicionin e punës “Specialist”), kryesuese e KPP-së;
- 2 anëtarë, janë zgjedhur nëpunës civilë të institucionit (të nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues), nëpunëset: Irena Stasa- Drejtor dhe Arsilda Male –Përgjegjës Sektori);
- 1 anëtar, Drejtor në Këshillin e Qarkut Vlorë, në cilësinë e eksperti –nëpunësja Anisa Hyseni;
- 1 anëtar, ekspert i fushës pedagoge, Univesiteti “Ismail Qemali”, Vlorë – Enida Pulaj.

Referuar pikës 5 dhe 6, të aktit nënligjor të sipërpërmendur, në lidhje me ekspertët në një procedurë pranimi në shërbimin civil, parashikohet:

“Ekspertët zgjidhen nga njësia përgjegjëse, për secilën KPP, duke pasur në konsideratë **karakteristikat e secilit grup pozicionesh**, për të cilët do të zhvillohet procedura e konkurrimit”.

“Ekspertët zgjidhen nga pedagogët e universiteteve apo institucioneve të tjera të arsimit të lartë, ekspertët e licencuar të fushave të ndryshme apo ekspertët që vijnë nga profesionet e rregulluara dhe që kanë të paktën 5 (pesë) vjet eksperiencë në atë pozicion pune/profesion”.

Në lidhje me sa më sipër, punonjësja Anisa Hyseni, nuk përfshihet në asnjë nga fushat e mësipërme, por duke qenë se KPP është organ kolegjal dhe 1 anëtar nuk e cënon në thelb procesin, Komisioneri tërheq vëmendjen e njësisë përgjegjëse që në të ardhmen të tregojë kujdes në përzgjedhjen e ekspertëve, në respektim të kërkesave të ligjit dhe aktit nënligjor.

Nga ana tjetër, rezulton se, për secilën procedurë pranimi në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive, njësia përgjegjëse e institucionit, ka ngritur *Komitetin e Përherhshëm të Pranimit*, ndërkohë që në parashikimet ligjore të nenit 22, të Ligjit 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe të pikës 2, të kreut III, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, i ndryshuar, parashtrohet se:

“Pranë institucioneve të pavarura dhe njësive të qeverisjes vendore krijohet një Komitet i Përherhshëm i Pranimit për secilin institucion”.

Në këtë komitet i cili duhet të jetë i përherhshëm përgjatë gjithë vitit kalendarik, ndryshojnë rast pas rasti vetëm ekspertët sipas fushës së konkurrimit që do të realizohet. Nga dokumentacioni i administruar në dosjen e konkurimit, rezulton të jetë ngritur një KPP (sqaruar në fillim të materialit) dhe **akti aktual duhet të lidhet me** Urdhërin e Brendshëm nr. 492 (15768 prot.) datë 29.09.2025 “*Për krijimin e Komitetit të Përherhshëm të Pranimit dhe të Komitetit të Ngritjes në Detyrë të punonjësve të administratës së Bashkisë Vlorë në funksion të shërbimit civil*”, duke cituar në përmbajtjen e tij: “*Për një ndryshim në Urdhërin nr. 492 (15768 prot.) datë 29.09.2025...*”).

- **Faza e Vlerësimit me shkrim**

- a) Nga dokumentacioni i administruar në dosjen e konkurrimit për plotësimin e pozicionit “*Specialist në Drejtorinë e Bashkëqeverisjes*”, në Bashkinë Vlorë, rezulton se, kanë aplikuar për fazën e pranimi në shërbimin civil **8** kandidatë A. Sulaj; B. Cela; G. Jaupaj; K. Muaj; Lori Liko; L. Selimaj; S. Selaj dhe U. Hënaj.

Rezulton se, pas përfundimit të afatit ligjor të ankimit, ashtu si e parashikon ligji, është dërguar në AKPA, lista përfundimare me aktin nr. 13503/4 prot., datë 22.09.2025, ku janë shtuar edhe 3 aplikantë: A. Demiraj; J. Abazaj dhe Xh. Myrtaj, si rezultat i plotësimit të dokumentacionit shtesë të kërkuar (e-maillet përkatëse të komunikimit, gjatë fazës së paraseleksionimit);

- b) Për pozicionin “*Specialist Administrator Shoqëror*”, në NJA Novoselë, në Drejtorinë e Ndihmës, Shërbimit Social”, në Bashkinë Vlorë, rezulton se, kanë aplikuar për fazën e pranimi në shërbimin civil **3** kandidatë: L. Selimaj, R. Hyso dhe U. Hënaj;

- ✓ Rezulton se, KPP është mbledhur për të hartuar pyetjet e testimit me shkrim dhe konstatohet se, janë hartuar 5 pyetje, të cilat janë nga fusha e njohurive të kërkuara në shpalljen e pozicionit vakant, sipas përcaktimit të pikës 9, kreu IV, i VKM-së nr.243, datë 18.3.2015, të ndryshuar.

- ✓ Kandidatët e kualifikuar, janë paraqitur për zhvillimin e testimit me shkrim, dokumentuar në procesverbalin e mbajtur dhe të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e KPP.

- **Faza e vlerësimit të jetëshkrimit dhe vlerësimi i intervistës së strukturuar me gojë**

- ✓ Rezulton se, KPP në të dyja rastet është mbledhur për hartimin e pyetjeve të intervistës së strukturuar me gojë, të cilat janë përzgjedhur brenda fushës së njohurive të kërkuara në shpalljen e pozicionit, (5 pyetje, për të dy pozicionet).

Në lidhje me intervistën me gojë, KPP, ka vepruar në këtë mënyrë:

- **Ka hartuar** pyetjet që lidhen me njohuritë, aftësitë, eksperiencën që nevojitet për pozicionin e punës dhe që janë brenda fushës së testimit të publikuara në shpallje, të cilat janë të njëjta për të gjithë kandidatët.
 - Brenda afateve të parashikuara, KPP, **ka zhvilluar intervistën me gojë** me secilin nga kandidatët dhe më pas ka hartuar raportin e procedurës së zhvilluar duke bërë vlerësimin, i cili, sipas udhëzimit të DAP, është i njëjtë me atë të lëvizjes paralele, por shuma totale, në këtë rast, pjesëtohet me pesë (*numri i vlerësuesve*).
 - Në të gjitha rastet, anëtarët e KPP, **kanë nënshkruar** deklaratën e paanësisë, duke deklaruar se nuk kanë konflikt interesi me kandidatët në konkurrim.
 - Në të gjitha rastet, kandidatët **kanë nënshkruar** deklaratat e pranimi ose mospranimi për të regjistruar intervistën me gojë.
 - Sipas pikës 15, të kreut IV, të VKM-së nr. 243, datë 18.3.2015, e ndryshuar, të gjithë kandidatët që kanë marrë më pak se 70 pikë (*70% të pikëve*), janë njoftuar individualisht nga njësia përgjegjëse, përmes postës elektronike;
- a. Në përfundim të vlerësimit, Njësia Përgjegjëse me aktin nr. 13503/5 prot., datë 09.10.2025, për pozicionin “*Specialist në Drejtorinë e Bashkëqeverisjes*” **ka hartuar listën fituese** për rezultatin e procedurës pranim në shërbimin civil dhe është dërguar për publikim në AKPA, duke renditur 3 kandidatë fitues: K. Muaj; A. Sulaj dhe L. Liko.

Rezulton se, në këtë institucion funksionon lista e pritjes për kandidatët fitues dhe për këtë arsye i është propozuar pozicioni i punës konkurentes Sabrina Xheja, e cila kishte grumbulluar pikët më të larta nga konkuret e mëparshme (*në qershor të vitit 2024, E-aili i datës 10.10.2025 i burimeve njerëzore*), ndërsa kandidatët e tjerë fitues, janë renditur sipas pikëve pasi kanë pranuar të qëndrojnë në listën e fituesve.

Në lidhje me sa më sipër kandidatja Sabrina Xheja, ka pranuar pozicionin dhe njësia përgjegjëse me aktin nr. 72 (16548 prot.) datë 13.10.2025, ka nxjerrë aktin e emërimit si nëpunëse civile në periudhë prove në pozicionin “*Specialist në Drejtorinë e Bashkëqeverisjes*”.

- b. me aktin nr. 13503/5 prot., datë 09.10.2025, për pozicionin “*Specialist Administrator Shoqëror*” në NJ.A Novoselë, **ka hartuar listën fituese** për rezultatin e procedurës pranim në shërbimin civil dhe është dërguar për publikim në AKPA, duke renditur 2 kandidatë fitues I. Selimaj dhe U. Hënaj.

Për pozicionin “*Specialist Administrator Shoqëror*” në NJ. A Novoselë”, në Drejtorinë e Ndhmës, Shërbimit Social, njësia përgjegjëse ka vijuar me nxjerrjen e aktit të emërimit të kandidatit fitues Lindita Selimaj, akti nr. 71 (16425 prot.,) datë 10.10.2025, si nëpunës civil në periudhë prove, ndërsa kandidatja tjetër ka pranuar listën e pritjes së kandidatëve fitues.

Nga sa u analizua më sipër, rezulton se, gjatë realizimit të procedurave të konkurrimit për plotësimin e dy pozicioneve të lira në kategorinë ekzekutive, janë konstatuar disa mangësi, të evidentuara gjatë zhvillimit të fazës së konkurrimit, të cilat vlerësohet se nuk janë të një natyre të tillë, që të sjellin pavlefshmëri të gjithë procesit të konkurrimit.

Parregullsitë e evidentuara në secilën fazë të konkurrimit, janë detyrim për tu ndjekur dhe zbatuar nga njësia përgjegjëse dhe anëtarët e Komiteteve, në të gjitha procedurat që do të zhvillohen në vijim, për lëvizjen paralele/pranimin në kategorinë ekzekutive.

Për këtë arsye, njësia përgjegjëse, pranë Bashkisë Vlorë, duhet të kujdeset për respektimin e kërkesave të mëposhtme gjatë zhvillimit të konkurrimeve në të ardhmen:

- Të tregojë kujdes në përfshirjen në planin vjetor për rekrutim, edhe të pozicioneve të reja vakante, që mund të krijohen gjatë vitit kalendarik, si një ndryshim i tij, në përputhje me përcaktimet e Vendimit nr. 108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për planin vjetor të pranimin në shërbimin civil*”, për plotësimin e tyre sipas procedurave të parashikuara në institutin e rekrutimit, me qëllim plotësimin e nevojave të institucionit;
- Njësia përgjegjëse e institucionit, duhet që në shpalljen e pozicionit të lirë të përcaktojë qartë **fushën kryesore mbi të cilën do të realizohet konkurrimi** si edhe publikimi **të bëhet për grup pozicionesh**, për të cilat lloji i diplomës që kërkohet dhe kërkesat e posaçme të pozicionit të punës janë të njëjta;
- Sa i takon ngritjes së organeve vlerësuese gjatë zhvillimit të procedurave të rekrutimit, duhet të kujdeset në respektimin e kërkesave të pikës 3, të kreut III dhe pikës 12, të kreut VII, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 18.3.2015, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, e ndryshuar, duke nxjerrë akte individuale për krijimin e secilit organ, sipas fazave të konkurrimit.

KPP-ja krijohet në fillim të vitit dhe ka të njëjtën përbërje për të gjitha procedurat e konkurrimit për pranim në shërbimin civil të zhvilluara gjatë vitit për këtë kategori nëpunësie dhe nuk ndërtohet rast pas rasti për çdo procedurë konkurrimi, pasi kërkon

anëtarë të kualifikuar dhe me njohuritë e duhura për këtë proces. Duhet të tregohet kujdes në përcaktimin e **ekspertëve të fushës, të cilët duhet të përshtaten me fushat ku do të zhvillohet konkurrimi**;

- Njësia përgjegjëse, të kujdeset që shpalljet në faqen zyrtare të institucionit apo në stendat e informimit të publikut, për secilën fazë të procedurës së konkurimit, si dhe çdo dokument të mbajtur gjatë procedurës së konkurimit, ti bëjë pjesë të dosjes së konkurimit, për efekt provues, se procedura në secilën fazë të saj është ndjekur ashtu si e parashikon ligji dhe aktet nënligjore;
- Sipas përcaktimeve të pikës 17, Kreu IV të Vendimit 243 datë 18.05.2018, ku parashkruhet shprehimisht: “...brenda 3 (tri) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të shqyrtimit të ankimeve të përcaktuara sipas pikës 22 të kreut IV të këtij vendimi, fton kandidatët fitues, duke respektuar renditjen e tyre, të zgjedhin nga lista e pozicioneve ekzistuese të lira, për të cilat kanë konkurruar. Kandidatët fitues kanë të drejtë të refuzojnë të zgjedhin, vetëm në rastin e parashikuar në shkronjën “b” të pikës 3, të nenit 48 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar”, njësia përgjegjëse duhet **të ftojë fituesin** që të japë miratimin/ose jo, për pozicionin për të cilin ka konkurruar që më pas, të dalë akti i emërimit, i cili duhet të finalizohet me nxjerrjen e aktit të fillimit të marrëdhënieve financiare nga titullari i institucionit (*akti i emërimit dhe akti i fillimit të efekteve financiare janë administruar në çdo dosje të konkurimit*).
- Nga të dhënat e procesverbalit të mbajtur nga grupi i punës, në lidhje me procedurat e konkurimit të zhvilluara në institucion, i cili është pjesë e projektraportit, rezulton se, në të gjitha rastet, është respektuar afati i dorëzimit të dokumentacionit, por kjo u verifikua në arkivën e institucionit, pasi në dosjet personale **mungonin** kërkesat për aplikim, të cilat duhet të jenë të protokolluara nga institucioni dhe pjesë e dosjes së konkurimit, e shoqëruar me inventarin përkatës.

VII. Plotësimi i pozicioneve të lira në shërbimin civil në nivelin ulët drejtues

Duke qenë se Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil nëpërmjet shkresave të protokolluara pranë tij me nr. 809 prot., datë 16.9.2025, nr. 809/1 prot., datë 24.9.2025, nr. 809/2 prot., datë 2.10.2025, si dhe e-mailit të datës 1.10.2025, ka administruar informacionin e dërguar nga kandidatja Alma Xhema, në të cilin kërkohet verifikimi i ligjshmërisë për procedurën e konkurimit për ngritje në detyrë, për pozicionin e lirë “Përgjegjës në Sektorin e Shpronësimeve”, në Drejtorinë e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, të shpallur nga Bashkia Vlorë. Grupi i punës, verifikoi në mënyrë të hollësishme të gjithë hapat proceduralë që ka ndjekur institucioni, për menaxhimin e procesit të konkurimit, ndër të cilat:

1. *Shpalljen e konkurimit për vendin e lirë në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, si dhe në faqen zyrtare të institucionit;*

2. Verifikimin paraprak nga njësia përgjegjëse, nëse kandidatët i plotësojnë ose jo kërkesat e përgjithshme dhe ato të posaçme sipas shpalljes së konkurrimit;
3. Vlerësimin e kandidatëve nga Komiteti i Pranimit për Lëvizjen Paralele dhe Komiteti i Pranimit për Ngritjen në Detyrë, i cili përfshin vlerësimin e jetëshkrimit të kandidatëve, testimin me shkrim dhe vlerësimin e intervistës së strukturuar me gojë;
4. Shpalljen e listës së fituesve, administrimin e kësaj liste nga njësia përgjegjëse dhe nxjerrjen e aktit të emërimit në shërbimin civil për kandidatët fitues.

Rregullat që duhet të ndjekë njësia përgjegjëse për organizimin e procedurës së konkurrimit për pozicionet e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues, janë të parashikuara në nenin 26, të ligjit për nëpunësin civil, në Kreun II dhe III, të Vendimit nr. 242, dt. 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, si dhe në kreun IV dhe V, të Udhëzimit nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”.

Bazuar në përcaktimet e pikës 1, të nenit 26, të ligjit për nëpunësin civil, plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët ose të mesme drejtuese bëhet, së pari, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe në rast të mosplotësimit të vendit të lirë, me procedurën e ngritjes në detyrë.

- Konstatohet se, **shpallja e procedurës së konkurrimit**, është dërguar në Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, për t’u publikuar në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, si dhe është publikuar në faqen e internetit të institucionit (akti nr. 13502 prot., datë 13.08.2025, i njësisë përgjegjëse i cili është nënshkruar nga punonjësja A. Plepi e ngarkuar me detyrën e Drejtorit të Burimeve Njerëzore, Urdhër i Brendshëm nr. 368 (12864 prot.) datë 01.08.2025, “Për Komandim në detyrë”, i Kryetarit të Bashkisë);
- Rezulton se janë respektuar rregullat e parashikuara në pikën 3 deri në 7, të Kreut II, të VKM nr. 242, d. 18.3.2015, i ndryshuar: në respektim të pikës 4 Kreu III, shpallja e procedurës së ngritjes në detyrë bëhet të paktën 35 ditë kalendarike para datës së parashikuar për zhvillimin e konkurrimit; afati i dorëzimit të dokumentacionit për lëvizje paralele të jetë jo më pak se 10 ditë kalendarike nga dita e parë e shpalljes (23.08.2025); për ngritje në detyrë jo më pak se 15 ditë kalendarike nga dita e parë e shpalljes (28.08.2025), është parashikuar saktë që aplikohet në të njëjtën kohë për të dy procedurat: lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë, duke përcaktuar për secilën procedurë afatin e dorëzimit të dokumenteve me datë të saktë kalendarike;
- Përsa i përket **procedurës së lëvizjes paralele**, konstatohet se nuk ka patur aplikantë të interesuar për këtë procedurë. Nga grupi i punës u verifikua, se në përmbajtjen e shpalljes për konkurrim janë përfshirë të gjitha kërkesat e parashikuara në pikën 8, të kreut II, të VKM nr. 242, dt. 18.3.2015, i ndryshuar. Njësia përgjegjëse, jo më vonë se 2 ditë kalendarike nga data e mbylljes së pranimit të dokumentave, **ka verifikuar**

dhe **ka shpallur** në portalin AKPA, si dhe në faqen zyrtare të institucionit, njoftimin për mbylljen e procedurës së lëvizjes paralele dhe vijimin me *procedurën konkurruese ngritje në detyrë* (shkresa nr. 13502/1 prot., datë 25.08.2025, edhe ky akt si për përmbyllje të procedurës, është nënshkruar nga punonjësja A. Plepi); (afati ligjor i ankimit, brenda 8 ditëve, nuk verifikohet të jetë përmbushur, pasi nuk ka një njoftim përfundimtar në AKP).

Në vijim të analizës, në lidhje me procedurat e konkurrimit për ngritje në detyrë, nisur nga rregullat që kanë lidhje me afatet ligjore që parashikohen në pikën 4 dhe 6, të Kreut III, të VKM nr. 242, dt. 18.3.2015, nga të dhënat e verifikuara rezulton se, **afatet janë respektuar** në të gjitha rastet.

Nga verifikimi i mëtejshëm rezulton se, në përmbajtjen e shpalljes për konkurrim, **janë përfshirë** të gjitha kërkesat e parashikuara në pikën 5, të kreut III, të VKM nr. 242, datë 18.3.2015, i ndryshuar, që janë:

- a) pozicioni i punës që është vakant (emërtesa e pozicionit sipas strukturës dhe organikës në fuqi);
- b) përshkrimi i përgjithshëm i punës për atë pozicion;
- c) kushtet për ngritjen në detyrë dhe kriteret e veçanta që duhet të plotësojnë kandidatët – Të zotërojnë një diplomë të nivelit “Master Shkencor”, edhe diploma e nivelit “bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë; Të ketë të paktën 5 vite ekperiencë punë në profesion;
- ç) dokumentet që duhet të dorëzohen nga kandidatët dhe mënyra e dorëzimit të tyre;
- d) afati i dorëzimit që është i përcaktuar me datë të saktë kalendarike;
- dh) data e daljes së rezultateve për fazën e verifikimit paraprak të kushteve minimale të procedurës së ngritjes në detyrë dhe të përmbushjes së kriterëve të veçanta të vendit të punës;
- e) fushën e njohurive, aftësitë dhe cilësitë që do të vlerësohen;
- f) mënyra e vlerësimit të kandidatëve;
- g) mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët.

Procedura e konkurimit e ngritjes në detyrë, sipas pikës 21, të Kreut III, të VKM-së së mësipërme, përfshin dy faza:

- Verifikimin paraprak, nëse kandidatët plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta për vendin/vendet e lira, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim;
- vlerësimin e kandidatëve.

➤ Verifikimi paraprak i kandidatëve

Verifikimi paraprak, realizohet nga njësia e burimeve njerëzore të institucionit, e cila, në bazë të pikës 22, 23 dhe 24, të Kreut III, të aktit nënligjor të mësipërm, në bazë të dokumentacionit të paraqitur, jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga data e mbylljes së pranimit të tyre, bën verifikimin paraprak të kandidatëve që përmbushin kushtet e

kërkesat e posaçme dhe brenda 10 ditëve kalendarike, që është përfundimi i afatit të ankimit, bën verifikimin përfundimtar.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dosjes së konkurimit rezultoi nëpunësja Anisa Plepi Specialiste në Drejtorinë Juridike, e ngarkuar me detyrën e Drejtorit të Burimeve Njerëzore (*njesisë përgjegjëse të institucionit*) ka shprehur interesin për të konkuruar për pozicionin “*Përgjegjës në Sektorin e Shpronësimeve*”, në Drejtorinë e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve (*kërkesa e saj për aplikim, e dorëzuar në protokoll me nr.13958 datë 25.08.2025*).

Ndodhur para faktit që nëpunësi i ngarkuar me detyrën e Drejtorit të Burimeve Njerëzore (*njëkohësisht edhe njësia përgjegjëse*), ka aplikuar për këtë procedurë konkurimi, Kryetari i Bashkisë, për të shmangur konfliktin e interesit, ka ngarkuar me urdhërin e brendshëm nr. (14599 prot.) datë 08.09.2025 “*Për komandim në detyrë*”, z. Alban Mësonjësi me detyrë “*Drejtore në Drejtorinë Juridike*” të zhvillojë procedurën e konkurimit në shërbimin civil për pozicionin e mësipërm.

Nga këqyrja e akteve, ka rezultuar se, lista me emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta të pozicionit të punës **është shpallur** në portalin AKPA, sipas aktit nr. 13502 prot., datë 08.09.2025 (*nënshkruar nga punjësi A. Mësonjësi*) dhe në faqen e internetit të institucionit, me një kandidat të kualifikuar, që plotësonte kushtet e ngritjes në detyrë, konkretisht aplikantja Anisa Plepi, e cila në momentin aktual të procesit ka qenë, nëpunëse civile e konfirmuar në pozicionin “*Specialist Jurist në Drejtorinë Juridike*”, në Bashkinë Vlorë.

Konstatohet se, kandidatja që ka aplikuar për procedurën e ngritjes në detyrë, **i plotëson** kushtet minimale dhe kërkesat e veçanta sipas shpalljes për konkurim, të përcaktuara në pikën 2, të Kreut III, të aktit nënligjor, si më poshtë:

- Është nëpunëse civile e konfirmuar, me kategori page sipas përcaktimit në shpallje, e vërtetuar me aktet përkatëse të konfirmimit të statusit nga institucionet ku ajo kryen detyrën (*akti nr. 11570 prot., datë 28.09.2024*);
- Nuk kanë masë disiplinore në fuqi, e vërtetuar me dokument lëshuar nga institucioni (*akti nr. 13835 prot., datë 21.08.2025*);
- Vlerësimet e punës për periudhën e fundit, sipas formatit të vlerësimit, të nënshkruar nga nëpunësit pjesëmarrës në vlerësim, janë në nivelin “*Mirë*” ose “*Shumë mirë*” (*formulari i vlerësimit të punës periudha 01.01.2025-30.06.2025 – 1 - “Shumë mirë”*).

Ndërkohë konstatohet se, konkurrentja Alma Xhema, kishte shprehur interesin për këtë pozicion pune, por që, për shkak të mos plotësimit të kriterit të arsimimit është skualifikuar e në këto kushte njësia përgjegjëse (*përfaqësuar nga A. Mësonjësi dhe specialisti i burimeve njerëzore*) në respektim të pikës 25, të aktit nënligjor të evidentuar më sipër, e ka njoftuar individualisht nëpërmjet e-mailit të datës 09.08.2025, të cilin ajo e ka ankimuar, pranë njesisë përgjegjëse të institucionit.

Konstatohet se, kandidatja nuk ka marrë përgjigje nga njësia përgjegjëse, me argumentin se, është menduar si e ezauruar si hallkë, për faktin se aplikantja nuk ka paraqitur dokumenta shtesë për të justifikuar arsyet e ankimimit. Në këto rrethana, njësia e burimeve njerëzore, ka vijuar me shpalljen e listës përfundimtare të kandidatëve të kualifikuar dhe me përcaktimin e datës së zhvillimit të testimit me shkrim, ku sipas aktit nr.13502/3 prot., datë 16.09.2025, është caktuar data e testimit 19.09.2025, ora 10.00.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se skualifikimi është kryer nga njësia përgjegjëse, në kushtet kur aplikantja nuk plotëson kriterin arsimor, i cili bëhet sipas një procedure të caktuar dhe nga subjekte të caktuara nga ligji.

➤ Vlerësimi i kandidatëve nga Komiteti i Pranimit për Ngritje në Detyrë (KPND).

Vlerësimi i kandidatëve për ngritjen në detyrë, realizohet nga Komiteti i Pranimit për Ngritje në Detyrë (KPND), i cili, sipas pikës 7, Kreu III, të VKM-së nr. 242, dt. 18.3.2015, i ndryshuar, përbëhet nga pesë anëtarë:

- a) 1 anëtar nga njësia përgjegjëse, i cili kryeson komitetin;
- b) 1 anëtar i zgjedhur nga titullari midis nëpunësve civilë të institucionit, nëse është e mundur të nivelit të mesëm drejtues;
- c) eprorin direkt të pozicionit për të cilin zhvillohet konkurrimi;
- d) 2 ekspertë të fushës përkatëse, në varësi të fushës së vlerësimit.

Në zbatim të kësaj dispozite, me Urdhrin e Brendshëm nr. 473, (15216 prot.), datë 18.09.2025, të Kryetarit të Bashkisë, “Për krijimin e Komitetit të Pranimit për Ngritjen në Detyrë për pozicionin “Përgjegjës në Sektorin e Shpronësimeve”, është ngritur Komiteti i Pranimit për Ngritjen në Detyrë, ndryshuar, me këtë përbërje:

- a) Irena Stasa, në cilësinë e nëpunësit të nivelit të mesëm drejtues;
- b) Kristotofor Kolaqi në cilësinë e eprorit direkt të pozicionit të shpallur (*I ngarkuar me detyrën e drejtorit për shkak të vakancave të krijuara në institucion*);
- c) Arsilda Male, Përgjegjëse në Drejtorinë e Bashkëqeverisjes, në cilësinë e përfaqësuesit të njësisë përgjegjëse;
- d) Loreta Tozaj, në cilësinë e ekspertëve të fushës -Pedagog;
- e) Enida Pulaj, në cilësinë e ekspertëve të fushës - Pedagog.

Në këto kushte Komisioneri nuk konstaton parregullsi në ngritjen dhe përbërjen e Komitetit të Pranimit për Ngritjen në Detyrë.

Në vijim të procedurës së ngritjes në detyrë, në bazë të përcaktimeve të pikës 6, të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pikave nga 27 deri në 33, të Kreut III, të VKM-së nr. 242, dt. 18.3.2015, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr. 2, datë 27.3.2015, të DAP, kandidatët e kualifikuar për të kaluar në fazën e dytë të konkurrimit, vlerësohen nga KPND, duke përfshirë:

- a) Vlerësimin e jetëshkrimit të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, përvojës e trajnimeve të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve individuale në punë (20 pikë);
- b) Vlerësimin me shkrim (40 pikë);
- c) Intervistën e strukturuar me gojë (40 pikë).

Për kryerjen e vlerësimit me shkrim të kandidatëve, anëtarët e KPND, **kanë përgatitur** testet përkatëse, të cilat, kanë qenë pyetje me shtjellim, që rezultojnë të nënshkruara nga të gjithë anëtarët e komitetit. Komiteti **ka hartuar** edhe çelësin e përgjigjeve. Pyetjet janë hartuar **brenda fushës së njohurive** dhe aftësive, kompetencave, mbi të cilat do të zhvillohej testimi, të përfshira në shpalljen për konkurrim. Anëtarët e KPND **kanë korrigjuar** testet dhe **kanë vlerësuar** në mënyrë individuale kandidatët duke dhënë pikët për secilin.

Gjatë këqyrjes së dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se, në vlerësimin me shkrim, anëtarët e KPND-së, kanë zbatuar rregullat e përcaktuara në pikën 8, të paragrafit III/6, të udhëzimit të DAP, duke pjestuar shumën totale të pikëve me pesë (në bazë të numrit të vlerësuesve).

Në përfundim të këtij testimi, si dhe të vlerësimit të jetëshkrimit (i cili është bërë sipas modelit të vlerësimit në Aneksin nr.7, bashkëlidhur udhëzimit të DAP), **kanë radhitur kandidaturat**, që janë kualifikuar për fazën e intervistës me gojë.

Në lidhje me intervistën me gojë, KPND - ja, ka vepruar në këtë mënyrë:

- **Ka hartuar** pyetjet që lidhen me njohuritë, aftësitë, eksperiencën që nevojiten për pozicionin e punës dhe që janë brenda fushës së testimit të publikuara në shpallje, të cilat janë të njejta për të gjithë kandidatët.
- ✓ Brenda afateve të parashikuara, KPND-ja, **ka zhvilluar intervistën** me gojë me secilin nga kandidatët dhe më pas ka hartuar raportin e procedurës së zhvilluar duke bërë vlerësimin, i cili, sipas udhëzimit të DAP, është i njejtë me atë të lëvizjes paralele, por shuma totale, në këtë rast, pjesëtohet me pesë (numri i vlerësuesve).
- ✓ Në të gjitha rastet, anëtarët e KPND-së, **kanë nënshkruar** deklaratën e paanësisë, duke deklaruar se nuk kanë konflikt interesi me kandidatët në konkurrim.
- ✓ Kandidatja **ka nënshkruar** deklaratën e mospranimit për të regjistruar intervistën me gojë.

Në përfundim të fazës së vlerësimit, KPND-ja, ka renditur kandidatët, duke filluar nga kandidati me rezultatin më të lartë dhe brenda afateve (brenda 24 orëve), ja ka dërguar njësisë së burimeve njerëzore, e cila, ka njoftuar individualisht kandidatët që kanë konkurruar, për rezultatin e tyre nëpërmjet *emailit*. Konstatohet se, **nuk ka patur ankesa** nga kandidatët për rezultatin e vlerësimeve dhe në këto kushte, brenda 24 orëve, njësia e burimeve njerëzore ka shpallur fituesin në portalin AKPA, si dhe në faqen zyrtare të institucionit dhe njëkohësisht ka dalë dhe akti i emërimit nga titullari i institucionit (*akt*

emërimi dhe akti i fillimit të marrëdhënieve financiare nr. 141 (15943 prot.) datë 02.10.2025 nga Kryetari i Bashkisë).

Nga sa më sipër, vlerësojmë se procedura e konkurimit për ngritje në detyrë e zhvilluar nga Bashkia Vlorë, është kryer në përputhje me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil.

VIII. Disa aspekte të tjera të zbatimit të ligjit, të evidentuara në lidhje me administrimin e shërbimit civil.

- ✓ Gjatë procesit të këqyrjes së akteve që materializojnë procesin objekt mbikëqyrjeje, grupi i punës, ka evidentuar faktin se për çdo pozicion pune të shpallur të lirë në institucion, si dhe për pozicionet e punës që konsiderohen aktualisht si pjesë e shërbimit civil, **është hartuar përshkrimi i punës**, në respektim të rregullave të vendosura në Vendimin nr.142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, ku janë përcaktuar misioni dhe qëllimi i përgjithshëm i punës, përgjegjësitë dhe detyrat kryesore, por nuk janë specialifikuar **kërkesat e posaçme** si kusht i domosdoshëm si dhe **nuk janë të nënshkruar** nga zyrtarët e ngarkuar nga ligji.
- ✓ Përsa i përket aplikimit të **institutit të përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil**, si rezultat i dorëheqjes dhe për shkak të ligjit gjatë peridhës objekt inspektimi, në bashkinë Vlorë, rezulton se kanë përfunduar marrëdhënien në shërbimin civil, punonjësit e evidentuar si më poshtë:
- **Laura Brinja**, me detyrë “Drejtor”, në Drejtor në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, me Akt - Lirimi nr. 104 (12257 prot.) datë 23.07.2025, “Për përfundimin e marrëdhënieve në shërbimin civil të punonjësve të Bashkisë Vlorë”, të Titullarit të Institucionit. Nëpunësja ka njoftuar Komisionerin nëpërmjet informacionit të datës 02.09.2025, rregjistruar pranë Komisionerit me nr. 793 prot., datë 08.09.2025, se nuk është dakord me aktin e lirimit të saj nga shërbimi civil, pasi ai ka dalë në kundërshtim me ligjin në fuqi.

Ndërkohë, grupi i punës, gjatë qëndrimit në subjekt, u informua, se me të njëjtin objekt, nëpunësja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, proces i cili është në vazhdim, çka provohet me Njoftimin nr. 2706 Akti, datë regjistrimi 13.10.2025, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë dhe kërkesë padinë e paditëses **Laura Brinja**, ndaj Bashkisë Vlorë.

Për sa më sipër, në bazë të përcaktimit në nenin 36, të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile” i ndryshuar, në përmbajtje të së cilit sanksionohet se, asnjë institucion tjetër shtetëror nuk mund të trajtojë çështje që po trajtohen apo janë trajtuar nga sistemi gjyqësor, vlerësojmë se, Komisioneri nuk mund të vijojë më tej, procedurën e hetimit të këtij rasti, pasi kjo mosmarrëveshje është bërë objekt i

shqyrtimit gjyqësor, në përfundim të së cilit do të japet zgjidhje përfundimtare pas trajtimit në themel të rastit.

- **Arlinda Tepelena**, me detyrë “Drejtor”, në Drejtorinë e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, me Akt - Lirimi nr. 106 (12613/1 prot.,) datë 31.07.2025, “Për përfundimin e marrëdhënieve në shërbimin civil të punonjësve të Bashkisë Vlorë”, të Titullarit të Institucionit, sipas **kërkesës së saj për dorëheqje**, në mbështetje të nenit 64, të ligjit nr.152/2013, i ndryshuar.
- **Dorian Demiri**, me detyrë “Drejtor i Përgjithshëm”, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore, me Akt - Lirimi nr. 93 (11602/1 prot.,) datë 16.07.2025, “Për përfundimin e marrëdhënieve në shërbimin civil të punonjësve të Bashkisë Vlorë”, të Titullarit të Institucionit, sipas **kërkesës së tij për dorëheqje**, në mbështetje të nenit 64, të ligjit nr.152/2013, i ndryshuar.
- **Kozma Mali**, me detyrë “Drejtor”, në Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit, me Akt - Lirimi nr. 91 (11614/1 prot.,) datë 16.07.2025, “Për përfundimin e marrëdhënieve në shërbimin civil të punonjësve të Bashkisë Vlorë”, të Titullarit të Institucionit, sipas **kërkesës së tij për dorëheqje**, në mbështetje të nenit 64, të ligjit nr.152/2013, i ndryshuar.
- **Olsi Durolli**, me detyrë “Drejtor i Përgjithshëm”, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike, Turizmit dhe Shërbimeve Mbështetëse, me Akt - Lirimi nr. 92 (11601/1 prot.,) datë 16.07.2025, “Për përfundimin e marrëdhënieve në shërbimin civil të punonjësve të Bashkisë Vlorë”, të Titullarit të Institucionit, sipas **kërkesës së tij për dorëheqje**, në mbështetje të nenit 64, të ligjit nr.152/2013, i ndryshuar.
- **Jovan Jaupaj**, me detyrë “Drejtor”, në Drejtorinë e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, me Akt - Lirimi nr. 90 (11603/1 prot.,) datë 16.07.2025, “Për përfundimin e marrëdhënieve në shërbimin civil të punonjësve të Bashkisë Vlorë”, të Titullarit të Institucionit, sipas **kërkesës së tij për dorëheqje**, në mbështetje të nenit 64, të ligjit nr.152/2013, i ndryshuar.
- **Zambak Selmani**, me detyrë “Drejtor”, në Drejtorinë e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike, me Akt - Lirimi nr. 103 (12211/1 prot.,) datë 23.07.2025, “Për përfundimin e marrëdhënieve në shërbimin civil të punonjësve të Bashkisë Vlorë”, të Titullarit të Institucionit, sipas **kërkesës së tij për dorëheqje**, në mbështetje të nenit 64, të ligjit nr.152/2013, i ndryshuar.
- **Sokol Kananaj**, me detyrë “Drejtor”, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, me Akt - Lirimi nr. 89 (11510/1 prot.,) datë 14.07.2025, “Për përfundimin e marrëdhënieve në shërbimin civil të punonjësve të Bashkisë Vlorë”, të Titullarit të Institucionit, sipas **kërkesës së tij për dorëheqje**, në mbështetje të nenit 64, të ligjit nr.152/2013, i ndryshuar.
- **Desilda Caci**, me detyrë “Drejtor”, në Drejtorinë e Bashkëqeverisjes, me Akt - Lirimi nr. 109 (12832/1 prot.,) datë 01.08.2025, “Për përfundimin e marrëdhënieve në shërbimin civil të punonjësve të Bashkisë Vlorë”, të Titullarit të Institucionit, sipas **kërkesës së saj për dorëheqje**, në mbështetje të nenit 64, të ligjit nr.152/2013, i ndryshuar.

- ✓ Për sa i përket **institutit të transferimit** në shërbimin civil, grupi i inspektimit administroi praktikën e transferimit të nëpunës **Aulona Veizi**, e cila kishte kërkuar nga Komisioneri, vlerësimin e ligjshmërisë së procedurës së ndjekur për transferimin e saj në pozicionin “Përgjegjës Sektori”.

Gjatë analizës së procesit të ristrukturimit, u konstatua se, njësia përgjegjëse e Institucionit pas vendimmarrjes së Komisionit të Ristrukturimit, të ngritur me Urdhërin nr. 180 prot., datë 19.05.2025 të Kryetarit të Bashkisë “Për ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit”, ka njoftuar nëpunësen, që pozicioni aktual të cilin ajo e mbante deri në momentin e ristrukturimit “Drejtor në Drejtorinë e Bujqësisë, Mbrojtjes së Mjedisit, Veterinarisë, Pyje dhe Kullota”, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore, nuk egziston më dhe në pamundësi për ti ofruar një vend në të njëjtën kategori, i është ofruar një pozicion i një kategorie më të ulët. Nëpunësi është njoftuar me aktin nr.9510/1 prot., datë 16.06.2025 “Njoftim vendimin e transferimit”, vendim të cilin nëpunësja e ka nënshkruar “Mora dijeni”, në datën 18.06.2026, (këtu konstatohet një gabim material që duhet të ndreqet, pasi është shënuar viti 2026, ndërkohë që duhet viti 2025, aktet administrohen në dosjen përkatëse të inspektimit). Më tej, njësia përgjegjëse ka vijuar me vendimin e transferimit nr. 40 (9510 prot.) datë 16.06.2025, në pozicionin “Përgjegjës në Sektorin e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Mjedisit, në Drejtorinë e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve”, pozicion në të cilin ajo kryen funksionet si nëpunëse civile.

- ✓ Gjatë procesit të inspektimit, u konstatua se disa nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive si dhe të nivelit të ulët drejtues, janë komanduar në detyra të nivelit të mesëm drejtues. Bëhet fjalë për punonjësit si më poshtë:
- Ingli Xhaferaj, nëpërmjet Urdhërit të Brendshëm nr. 512 (16107 prot.) datë 03.10.2025, “Për Komandim në detyrë”, të Kryetarit të Bashkisë, është komanduarnë detyrën e Drejtorit në Drejtorinë e Urbanistikës. Ky punonjës, në momentin e komandimit ka kryer funksionin në pozicionin e punës “Specialist arkitekt”, në Drejtorinë e Urbanistikës;
- Orges Deraj, nëpërmjet Urdhërit të Brendshëm nr. 315 (11826 prot.) datë 17.07.2025, “Për Komandim në detyrë”, të Kryetarit të Bashkisë, është komanduar në detyrën e Drejtorit në Drejtorinë e Urbanistikës. Ky punonjës, në momentin e komandimit ka kryer funksionin në pozicionin e punës “Specialist arkitekt”, në Drejtorinë e Urbanistikës. Nëpunësi ka njoftuar Komisionerin që nuk i është vënë në dispozicion urdhëri i ndërprerjes së komandimit, (akti rregjistruar pranë Komisionerit me nr. 973 prot., datë 12.11.2025). Në këtë rast, u verifikua që punonjësi është njoftuar për tërheqjen e aktit të ndërprerjes së komandimit, me e-mailin e datës 09.10.2025, nga njësia përgjegjëse;
- Ergita Kamberi, nëpërmjet Urdhërit të Brendshëm nr. 367 (12834 prot.) datë 31.07.2025, “Për Komandim në detyrë”, të Kryetarit të Bashkisë, është komanduar në detyrën e Drejtorit në Drejtorinë e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik. Ky punonjës, në momentin e komandimit ka kryer funksionin në pozicionin e punës “Specialist”, në Drejtorinë e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik;

- Aida Hitaj, nëpërmjet Urdhërit të Brendshëm nr. 299 (11606 prot.) datë 15.07.2025, “Për Komandim në detyrë”, të Kryetarit të Bashkisë, është komanduar në detyrën e Drejtorit në Drejtorinë e Protokoll – Arkivës. Ky punonjës, në momentin e komandimit ka kryer funksionin në pozicionit të punës “Përgjegjës Sektori”, në Drejtorinë e Protokoll - Arkivës;
- Lirika Gavani, nëpërmjet Urdhërit të Brendshëm nr. 300 (11607 prot.) datë 15.07.2025, “Për Komandim në detyrë”, të Kryetarit të Bashkisë, është komanduar në detyrën e Drejtorit në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm Ky punonjës, në momentin e komandimit kryen funksionin e pozicionit të punës “Përgjegjës”, në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm;
- Albana Naci, nëpërmjet Urdhërit të Brendshëm nr. 237 (11604 prot.) datë 15.07.2025, “Për Komandim në detyrë”, të Kryetarit të Bashkisë, është komanduar në detyrën e Drejtorit në Drejtorinë e Projekteve të Huaja, Integritetit Euroipian dhe Diasporës. Ky punonjës, në momentin e komandimit ka kryer funksionin e pozicionit të punës “Specialist”, në Drejtorinë e Projekteve të Huaja, Integritetit Euroipian dhe Diasporës;
- Fatmir Llanaj, nëpërmjet Urdhërit të Brendshëm nr. 296 (11512 prot.) datë 14.07.2025, “Për Komandim në detyrë”, të Kryetarit të Bashkisë, është komanduar në detyrën e Drejtorit në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore. Ky punonjës, në momentin e komandimit ka kryer funksionin e pozicionit të punës “Përgjegjës”, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore;
- Hiqmet Haxhaj, nëpërmjet Urdhërit të Brendshëm nr. 306 (11648 prot.) datë 16.07.2025, “Për Komandim në detyrë”, të Kryetarit të Bashkisë, është komanduar në detyrën e Drejtorit në Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit. Ky punonjës, në momentin e komandimit ka kryer funksionin e pozicionit të punës “Përgjegjës”, në Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit;
- Kristofor Kolaqi, nëpërmjet Urdhërit të Brendshëm nr. 333 (12174 prot.) datë 23.07.2025, “Për Komandim në detyrë”, të Kryetarit të Bashkisë, është komanduar në detyrën e Drejtorit në Drejtorinë e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve. Ky punonjës, në momentin e komandimit ka kryer funksionin e pozicionit të punës “Specialist jurist”, në Drejtorinë e Urbanistikës.

Në lidhje me këtë situatë, Komisioneri vlerëson se nuk është vepruar drejt dhe në përputhje me ligjin, nga titullari i institucionit, për disa arsye, duke nisur nga fakti se, “Komandimi në detyrë”, nuk është një institut i parashikuar në ligjin për nëpunësin civil. Në rastin konkret ndodhemi përpara faktit që, nëpunësve civilë të caktuar, të nivelit egzekutiv (në 5 raste) dhe nëpunës civil të nivelit të ulët drejtues (në 4 raste), i janë ngarkuar detyra specifike të pozicioneve të punës, që përfshihen në nivelin mesëm drejtues, që është nivel më i lartë, se statusi që ata gëzojnë në shërbimin civil. Konstatohet se, në veprimtarinë e përditëshme të institucionit, këta punonjës kanë nënshkruar në akte, sipas funksioneve ku janë komanduar për të kryer detyrat, si Përgjegjës Sektori, apo Drejtor Drejtorie.

Ky veprim vjen në kundërshtim, së pari me **a)** parimin e hierarkisë administrative, dhe së dyti, me **b)** parimin e profesionalizmit dhe zhvillimit të karrierës në shërbimin civil.

Respektimi i parimit të hierarkisë administrative, materializohet në strukturën organizative të institucionit. Sipas këtij parimi, përgjegjësitë e pozicioneve në mungesë, kalojnë në një nivel më të lartë në hierarkinë administrative, ndërkohë që në këtë rast ka ndodhur e kundërta, përgjegjësitë kanë kaluar në nivele më të ulëta të strukturës organizative.

Nga ana tjetër, respektimi i parimit të profesionalizmit dhe zhvillimit të karrierës në shërbimin civil, materializohen në zbatimin e procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet konkurrimit, nëpërmjet transferimit të përkohshëm, nëpërmjet aplikimit të listës së pritjes, apo raste të tjera të parashikuara në ligjin për nëpunësin civil.

Në rastin konkret, janë ngarkuar me detyra të caktuara, nëpunës të nivelit ekzekutiv, apo të nivelit të ulët drejtues, të cilët, nuk janë të provuar sipas procedurave ligjore, për aftësitë e tyre profesionale në kryerjen e detyrave që kanë lidhje me vendimmarrje të caktuara. Sipas ligjit, përgjegjësitë e pozicioneve në mungesë, kalojnë në një nivel më të lartë në hierarkinë administrative, por edhe në këtë rast, kjo situatë lidhet me një periudhë kohore të caktuar, që përkon me mungesa afatshkurtra, të tilla si raporte mjekësore, apo raste të tjera të kësaj natyre. Për analogji dhe për të unifikuar praktikën në këtë rast, mund të përdoret edhe ligji nr. 90/2012 *“Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”*, i cili i përcakton me hollësi këto rregulla.

Në këto rrethana, titullari i institucionit, në përputhje me nenin 109 dhe 113 të Kodit të Procedurave Administrative, duhet të marrë masa të menjëhershme për anulimin e akteve të **“komandimit në detyrë”**, të punonjësve të nivelit ekzekutiv dhe të nivelit të ulët drejtues, përkatësisht të caktuar në nivele të mesme drejtuese, ashtu si është evidentuar më sipër, si akte që kanë dalë në kundërshtim me ligjin për nëpunësin civil.

Nga ana tjetër, duhet të merren masa të menjëhershme për plotësimin e pozicioneve të lira në përputhje me ligjin për nëpunësin civil, duke i përfshirë këto pozicione në planin e rekrutimit, me qëllim që të fillojë procesi i rregullt ligjor për publikimin e tyre.

Punonjësit në fjalë, të ngarkuar me këto detyra përtej statusit të tyre të nëpunësit civil, të vijnë të kryejnë detyrat në funksionet e tyre, ku janë emëruar në zbatim të procedurave ligjore të rekrutimit.

IX. Dosjet e personelit

Dosjet e personelit janë krijuar dhe administrohen në përputhje me përcaktimet e nenit 17, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe kërkesave të Vendimit nr. 833, datë 28.10.2020, të Këshillit të Ministrave, *“Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”*.

Nga këqyrja e dosjeve të personelit, u konstatua se, në përmbajtjen e tyre, **janë të përfshira** të gjitha të dhënat dhe dokumentacioni i përcaktuar në lidhjen 1, bashkëlidhur

VKM nr. 833, datë 28.10.2020, ndërsa, Fleta e inventarit dhe Fleta prezantuese e dosjes së personelit, janë sipas lidhjes 2, që i bashkëlidhet aktit nënligjor.

Nga verifikimi i dosjeve të personelit, rezulton se ato janë të rregullta, të sistemuara dhe ruhen në kushte të përshtatshme, në ambientet e institucionit dhe administrohen nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, e cila përfaqëson edhe njësinë përgjegjëse për administrimin e burimeve njerëzore për institucionin.

Nga sa u analizua në pjesën arsyetuese të këtij vendimi, arrijmë në përfundimin se, gjatë realizimit të procedurave të konkurrimit për plotësimin e pozicioneve vakante të krijuara në periudhën Korrik – Tetor 2025, janë konstatuar disa mangësi, të aspektit procedural, të evidentuara gjatë zhvillimit të fazës së konkurrimit, të cilat vlerësohet se nuk janë të një natyre të tillë, që të sjellin pavlefshmëri të gjithë procesit të konkurrimit.

Parregullsitë e evidentuara në secilën fazë të konkurrimit, të sqaruara në pjesën arsyetuese të vendimit, janë detyrim për tu ndjekur dhe zbatuar nga njësia përgjegjëse dhe anëtarët e organeve të rekrutimit, në të gjitha procedurat që do të zhvillohen në vijim, për të gjitha kategoritë e nëpunësisë civile.

Njësia përgjegjëse dhe aktorët e tjerë të procesit, duhet të marrin masa të menjëhershme, në këto drejtime:

- Të përgatitet plani i nevojave për rekrutim për vitin 2026, për pozicionet e lira, në përputhje me përcaktimet e Vendimit nr. 108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimi në shërbimin civil”, sipas orientimeve të dhëna më sipër;
- Për çdo pozicion pune, pjesë e shërbimit civil, të plotësohet **përshkrimi i punës**, në rubrikat: “Kërkesat e posaçme”, kërkesat për kriterin arsimor apo kriterin e eksperiencës së nevojshme për pozicionin e punës, të cilat duhen të vendosen sipas përcaktimeve të lidhjes nr. 2, pika 2/2, të Vendimit nr.142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të ndryshuar;
- Të miratohen këto akte nga aktorët e ngarkuar nga ligji, si dhe të nënshkruhen nga eprori direkt dhe nëpunësi i emëruar në pozicionin respektiv, me qëllim përfundimin e procesit të hartimit dhe miratimit të përshkrimeve të punës, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në vendimin nënligjor në fjalë dhe udhëzimin nr. 1, datë 31.5.2017, të Departamentit të Administratës Publike, “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”, e më pas kopje e përshkrimeve të punës të nënshkruara, të bëhen pjesë e dosjes së personelit të çdo nëpunësi civil;
- Në bashkëpunim me eprorin e pozicionit vakant, duhet që në shpalljen e pozicionit të lirë të përcaktohet qartë **fusha e legjislacionit** në të cilin do të zhvillohet testimi i kandidatëve, me qëllim që testimi i tyre të bëhet vetëm për fusha, të cilat diktohen nga pozicioni i punës, ku ato konkurrojnë, në mënyrë që, nga njëra anë kandidatët të mos vendosen në kushte jo të favorshme dhe nga ana tjetër, vlerësimi i kandidatëve të jetë sa më real dhe objektiv;

- Sa i takon ngritjes së organeve vlerësuese (KPP) gjatë zhvillimit të procedurave të rekrutimit, duhet të tregohet kujdes në respektimin e kërkesave të pikës 3, të kreut III dhe pikës 12, të kreut VII, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 18.3.2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar, duke nxjerrë akte individuale për krijimin e secilit organ, sipas fazave të konkurrimit.
- Titullari i institucionit, duhet të marri masa të menjëhershme për anulimin e akteve të **“komandimit në detyrë”**, të punonjësve të nivelit ekzekutiv dhe të nivelit të ulët drejtues, përkatësisht të caktuar në nivele të mesme drejtuese, si akte që kanë dalë në kundërshtim me ligjin për nëpunësin civil.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, referuar Seksionit III, “Procedura hetimore”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Përfundimin e hetimit administrativ të nisur me urdhrin e inspektimit nr. 103 (nr. 905 prot.) datë 03.11.2025 të Komisionerit “Për kryerjen e inspektimit të thelluar, në lidhje me zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil gjatë zhvillimit të procedurës së konkurrimit për plotësimin e pozicioneve vakante të krijuara në periudhën Korrik – Tetor 2025, në institucionin e Bashkisë Vlorë”, si dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar situatën e ligjshmërisë sipas detyrave që do të evidentohen në vijim.
2. Të përgatitet plani i nevojave për rekrutim për vitin 2026, për pozicionet e lira, në përputhje me përcaktimet e Vendimit nr. 108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, duke përfshirë të gjitha pozicionet e lira në institucion dhe të vijnë procedurat për plotësimin e tyre.
3. Për çdo pozicion pjesë e shërbimit civil, të plotësohet formulari i **përshkrimit të punës**, në rubrikën “Kërkesat e posaçme”, ku përfshihen kërkesat për kriterin arsimor apo kriterin e eksperiencës së nevojshme për pozicionin e punës.
4. Të finalizohet procedura e hartimit dhe miratimit të akteve të përshkrimit të punës nga aktorët e ngarkuar prej ligjit për nëpunësin civil, nëpërmjet nënshkrimit të tyre, si dhe të plotësohet Regjistri Qendror i Personelit, sipas kërkesave të ligjit.

5. Sa i takon ngritjes së organeve vlerësuese gjatë zhvillimit të procedurave të rekrutimit, të ngrihet KPP për vitin 2026, në respektim të kërkesave të ligjit, duke nxjerrë akte individuale për krijimin e secilit organ, sipas fazave të konkurrimit.
6. Titullari i institucionit duhet të marri masa të menjëhershme për anulimin e akteve të **“komandimit në detyrë”**, të nëpunësve civilë të nivelit ekzekutiv dhe të nivelit të ulët drejtues, për të kryer detyrat e nëpunësve civilë të nivelit të mesëm drejtues, si akte të nxjerra në kundërshtim me ligjin për nëpunësin civil.
- Të merren masa të menjëhershme për plotësimin e pozicioneve të lira në përputhje me ligjin për nëpunësin civil dhe punonjësit e mëposhtëm të ngarkuar me këto detyra, të rikthehen në detyrat për të cilat gëzojnë statusin e nëpunësit civil:
- Ingli Xhaferaj, nëpërmjet Urdhërit të Brendshëm nr. 512 (16107 prot.), datë 03.10.2025, “Për Komandim në detyrë”, të Kryetarit të Bashkisë, është komanduar në pozicionin e Drejtorit në Drejtorinë e Urbanistikës. Ky punonjës, në momentin e komandimit, ka kryer funksionet në pozicionin e punës “Specialist arkitekt”, në Drejtorinë e Urbanistikës;
 - Orges Deraj, nëpërmjet Urdhërit të Brendshëm nr. 315 (11826 prot.), datë 17.07.2025, “Për Komandim në detyrë”, të Kryetarit të Bashkisë, është komanduar në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Urbanistikës. Ky punonjës, në momentin e komandimit ka kryer funksionin në pozicionin e punës “Specialist arkitekt”, në Drejtorinë e Urbanistikës. Nëpunësi ka njoftuar Komisionerin që nuk i është vënë në dispozicion akti i ndërprerjes së komandimit. Aktualisht është njoftuar për tërheqjen e aktit të ndërprerjes së komandimit me e-mailin e datës 09.10.2025, nga njësia përgjegjëse;
 - Ergita Kamberi, nëpërmjet Urdhërit të Brendshëm nr. 367 (12834 prot.), datë 31.07.2025, “Për Komandim në detyrë”, të Kryetarit të Bashkisë, është komanduar në pozicionin e Drejtorit në Drejtorinë e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik. Kjo punonjëse, në momentin e komandimit ka kryer funksionin në pozicionin e punës “Specialist”, në Drejtorinë e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik;
 - Aida Hitaj, nëpërmjet Urdhërit të Brendshëm nr. 299 (11606 prot.), datë 15.07.2025, “Për Komandim në detyrë”, të Kryetarit të Bashkisë, është komanduar në pozicionin e Drejtorit në Drejtorinë e Protokoll – Arkivës. Kjo punonjëse, në momentin e komandimit ka kryer funksionin në pozicionin e punës “Përgjegjës Sektori”, në Drejtorinë e Protokoll - Arkivës;
 - Lirika Gavani, nëpërmjet Urdhërit të Brendshëm nr. 300 (11607 prot.), datë 15.07.2025, “Për Komandim në detyrë”, të Kryetarit të Bashkisë, është komanduar në pozicionin e Drejtorit në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm. Kjo punonjëse, në momentin e komandimit ka kryer funksionin në pozicionin e punës “Përgjegjës”, në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm;
 - Albana Naci, nëpërmjet Urdhërit të Brendshëm nr. 237 (11604 prot.), datë 15.07.2025, “Për Komandim në detyrë”, të Kryetarit të Bashkisë, është komanduar në pozicionin e Drejtorit në Drejtorinë e Projekteve të Huaja, Integritetit Euroipian dhe Diasporës. Kjo punonjëse, në momentin e komandimit

- ka kryer funksionin në pozicionin e punës “*Specialist*”, në Drejtorinë e Projekteve të Huaja, Integritetit Euroipan dhe Diasporës;
- Fatmir Llanaj, nëpërmjet Urdhërit të Brendshëm nr. 296 (11512 prot.) datë 14.07.2025, “*Për Komandim në detyrë*”, i Kryetarit të Bashkisë, është komanduar në pozicionin e Drejtorit në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore. Ky punonjës, në momentin e komandimit ka kryer funksionin e pozicionit të punës “*Përgjegjës*”, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore;
 - Hiqmet Haxhaj, nëpërmjet Urdhërit të Brendshëm nr. 306 (11648 prot.) datë 16.07.2025, “*Për Komandim në detyrë*”, të Kryetarit të Bashkisë, është komanduar në pozicionin e Drejtorit në Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit. Ky punonjës, në momentin e komandimit ka kryer funksionin në pozicionin e punës “*Përgjegjës*”, në Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit;
 - Kristofor Kolagji, nëpërmjet Urdhërit të Brendshëm nr. 333 (12174 prot.) datë 23.07.2025, “*Për Komandim në detyrë*”, të Kryetarit të Bashkisë, është komanduar në pozicionin e Drejtorit në Drejtorinë e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve. Ky punonjës, në momentin e komandimit ka kryer funksionin në pozicionin e punës “*Specialist jurist*”, në Drejtorinë e Urbanistikës;
7. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **2 muaj** nga marrja dijeni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të njoftojë për këtë vendim të gjithë aktorët që janë të ngarkuar prej ligjit për shërbimin civil që kryejnë detyra specifike në këtë rast, duke u bazuar në orientimet e dhëna në përmbajtjen e vendimit.
8. Të njoftohet për këtë vendim institucioni i Bashkisë Vlorë, duke i dërguar një kopje të vendimit.
9. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, nga subjektet përkatëse, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Lefterije Lleshi (Luzi)

